



ToR: Shërbime të këshillimit dhe përfaqësimit ligjor

Informata të përgjithshme

Organizata: Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)

Projekti: Enhancing Transitional Justice Effectiveness

Donatori/Programi: Global Initiative Against Impunity

Aktiviteti: Mbështetje për të mbijetuarit e të dhunës seksuale të luftës në proceset ligjore

Lloji i angazhimit: Ofrues i shërbimeve ligjore

Kohëzgjatja e angazhimit: Qershor – Tetor 2025

Lokacioni: Kosovë

Rreth QKRKT-së

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1999 që ofron shërbime ndërdisiplinore në mbështetje të viktimave civile të luftës, në veçanti të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Këto shërbime përfshijnë terapi mjekësore dhe psikologjike për të mbijetuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre, ndërgjegjësim mbi të drejtat e tyre ligjore, këshilla ligjore, programe fuqizimi ekonomik, dhe aktivitete që synojnë njohjen institucionale të të drejtave të tyre. Për më tepër, QKRKT është e përfshirë në identifikimin, vlerësimin, trajtimin, referimin dhe monitorimin e të mbijetuarve të Dhunës me Bazë Gjinore (DHBGJ) midis të riatdhesuarve, personave nën moshën 18 vjeçare, si dhe refugjatëve, azil kërkuarve, persona të zhvendosur brenda vendit dhe persona në rrezik pa shtetësi. Përveç kësaj, brenda mandatit të saj për të promovuar dhe çuar përpara respektimin e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria, QKRMT-ja kryen vizita të rregullta monitorimi në vendet e mbyllura, si: burgjet dhe qelitë e paraburgimit të policisë. Gjithashtu promovon praktikën dhe standardet legjislative për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. QKRMT-ja e sheh rolin e saj në shoqëri si ofrues shërbimesh psikosociale dhe ligjore, si dhe mbikëqyrës i të drejtave të njeriut. Me rëndësi të veçantë është avokimi i vazhdueshëm që QKRMT ka bërë me institucionet qeveritare në adresimin e nevojave të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, si dhe personave të privuar nga liria.

1. Konteksti

QKRMT, në kuadër të mandatit të saj për rehabilitim, fuqizim dhe qasje në drejtësi për të mbijetuarit e torturës dhe dhunës seksuale gjatë luftës, zbaton projektin *Enhancing Transitional Justice Effectiveness*, i cili synon forcimin e qasjes në drejtësi dhe rritjen e efektivitetit të proceseve të drejtësisë tranzicionale.

Në kuadër të këtij projekti, parashihet ofrimi i mbështetjes së drejtpërdrejtë ligjore për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës, përmes këshillimit, përfaqësimit dhe asistencës procedurale në proceset penale dhe administrative.



2. Qëllimi i angazhimit

Qëllimi i këtij angazhimi është ofrimi i shërbimeve profesionale ligjore për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës, me qasje të ndjeshme ndaj traumës, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe përfaqësim efektiv në procedurat përkatëse.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë

Ofruesi i shërbimeve, sipas kërkesës së QKRMT-së, do të realizojë detyrat në vijim:

- Ofrimi i këshillimit ligjor individual për të mbijetuarit mbi të drejtat e tyre dhe hapat në procedurat penale dhe administrative.
- Përgatitja e kallëzimeve penale dhe dokumenteve të tjera procedurale në rastet penale.
- Hartimi dhe dorëzimi i parashtrësave dhe ankesave administrative, sipas nevojave të rastit.
- Përfaqësimi i të mbijetuarve në procedurat administrative, përfshirë paraqitjet zyrtare, seancat dëgjimore dhe komunikimin me organet administrative.
- Përgatitja e të mbijetuarve për intervista, dëshmi dhe paraqitje zyrtare, duke siguruar qasje të ndjeshme ndaj traumës dhe duke respektuar parimin “do no harm”.
- Prani dhe asistencë gjatë intervistave dhe veprimeve procedurale në proceset penale dhe administrative.
- Raportim periodik dhe dokumentim profesional i aktiviteteve të realizuara, duke ruajtur konfidencialitetin, etikën profesionale dhe standardet e mbrojtjes së të mbijetuarve.

4. Rezultatet e pritshme

- Rritje e qasjes së të mbijetuarve në drejtësi përmes përfaqësimit efektiv ligjor.
- Përgatitje cilësore e dokumentacionit procedural dhe ndjekje aktive e rasteve.
- Rritje e kapacitetit të të mbijetuarve për të kuptuar dhe naviguar proceset ligjore.
- Dokumentim i strukturuar dhe raportim në përputhje me kërkesat e projektit.

5. Kualifikimet dhe kërkesat

- Diplomë universitare në Drejtësi.
- Minimum 10 vite përvojë në të drejtën penale dhe/ose administrative.
- Përvojë në punë me kategori të ndjeshme, veçanërisht me të mbijetuar të dhunës seksuale të luftës.
- Njohuri mbi qasjen e ndjeshme ndaj traumës dhe standardet e mbrojtjes së viktimave.
- Integritet profesional, etikë e lartë dhe aftësi për të ruajtur konfidencialitetin.

6. Raportimi dhe mbikëqyrja

Ofruesi i shërbimeve do të raportojë tek Menaxheri/ja i/e Projektit në QKRMT dhe do të koordinohet ngushtë me ekipin psikosocial për të siguruar qasje multidisiplinare dhe mbështetje gjithëpërfshirëse për të mbijetuarit.

7. Parimet Themelore

- Konfidencialitet i plotë dhe mbrojtje e të dhënave personale.
- Qasje e ndjeshme ndaj traumës dhe respektim i dinjitetit të të mbijetuarve.
- Mosdiskriminim dhe respektim i standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

- Përputhshmëri me politikat e brendshme të QKRMT-së dhe standardet e projektit.

8. Procesi i aplikimit:

Kandidatët e interesuar ftohen të dorëzojnë CV-në e tyre në QKRMT në info@krct.org deri më 13 maj 2025.